

26. Organizatat e krishtera që ofrojnë shtëpi të sigurt dhe trajnime pune për vajzat e reja të prekshme ndaj trafikimit seksual. Lutuni që ato të "qëndrojnë të forta e të patundura, duke tepruar përherë në veprën e Zotit, duke e ditur se munda i tyre nuk është i kotë në Zotin." (1 Korintasve 15:58).

27. Të krishterët të jenë kanale të dashurisë dhe dhembshurisë së Zotit për gratë dhe vajzat të cilat janë plagosur thellë nga abuzimi fizik dhe seksual.

28. Fëmijët që përjetojnë neglizhime dhe abuzime në shtëpitë e tyre. Shumë fëmijë të neglizhuar bien në kurthin e prostitucionit, pornografisë dhe punë të ngjashme skllavërie në vende të tjera ose edhe në komunitetet e tyre.

29. Qeveritë të bëjnë më shumë për të ndihmuar të varfrit e tyre duke krijuar kushte në të cilat njerëzit mund të fitojnë aftësi dhe të gjejnë punë të ndershme.

30. Viktimat e trafikimit, prostitucionit dhe dhunimit që janë braktisur dhe stigmatizuar nga vetë populli që duhet t'i kishte mbrojtur ato. Lutuni që ato të provojnë shërimin dhe restaurimin në Krishtin dhe si rrjedhojë të jenë në gjendje t'u besojnë njerëzve përsëri.

31. Vajzat që detyrohen të bëhen nuse të shumë burrave të moshuar dhe në disa raste janë "gratë" e përkohshme të divorcuara ose të shitura me lehtësi në prostitucion.

Dëgjoni programin "Shpresë për ty" në:

Radio 7: 97,7 FM: të shtunën ora 8:30

Radio Emanuel: 95,7 FM të shtunë ora 9:00

Radio Logos: 94,2 FM të shtunë/ të dielë ora 9:00 dhe 17:00

Sot në botë ka 40 milionë skllavër. Si e kemi lejuar që kjo të ndodhte? Shumica prej nesh me siguri supozojnë se ky krim i tmerrshëm kundër dinjitetit themelor njerëzor ka vdekur shumë kohë më parë. Por trafikimi i qenieve njerëzore, duke përfshirë skllavërinë seksuale dhe martesat e detyruara, vazhdon të jetë një problem mbarëbotëror që ka një ndikim shkatërrues tek vajzat, gratë, familjet e tyre dhe komunitetet e tyre.

- Sipas raportit të Vlerësimeve Globale të Organizatës Ndërkombëtare të Punës për Skllavërinë Moderne:

- Përgjatë 2016, rreth 40.3 milionë njerëz jetonin në skllavëri moderne, duke përfshirë 24.9 milionë në punë të detyruar dhe 15.4 milion në martesat të detyruara.

- Nga 24.9 milion njerëz të zënë në kurthin e punës së detyruar, 16 milion janë shfrytëzuar në sektorin privat në punë të tilla si puna shtëpiake, ndërtimi ose bujqësia; 4.8 milion kanë përjetuar shfrytëzimin seksual të detyruar; dhe 4 milion përballen me punë të detyruara të vendosura nga autoritetet shtetërore.

- Gratë dhe vajzat ndikohen në mënyrë joproportionale nga puna e detyruar, duke përbërë 99 për qind të viktimave në industrinë e seksit komercial dhe 58 për qind në sektorë të tjerë.

TWR Shpresë për ty ka prodhuar radiodramën "Thesare të fshehura", të regjistruar në pajisjet e dorës që shpërndahen nga organizata të ndryshme për të arritur tek gratë e shfrytëzuara seksualisht. Duke përdorur dëshmitë e grave që dikur kanë punuar në prostitucion, këto audio drama trajtojnë çështje të ndjeshme sociale, fizike, psikologjike, mjekësore dhe emocionale në një mënyrë jo-kërcënuese por profesionale nga perspektiva e krishterë. Radiodramat "Thesare të fshehura" u hartua me synimin përfundimtar për të futur Jezusin si mik, Shpëtimtar dhe shërues dhe për t'i treguar grave vlerën dhe qëllimin e dhënë nga Perëndia.

Do të të jap thesaret e territ dhe pasuritë e fshehura në vende të fshehta, me qëllim që ti të njohësh që unë jam Zoti, Perëndia i Izraelit, që të thërret me emër. Isaia 45:3

Të lutemi për Viktimat e Trafikimit Njerëzor



Dëgjoni kalendarin e lutjes online
në: twr-albania.com

Të lutemi për...

1. Gratë dhe vajzat që joshen në industrinë e paligjshme dhe shumë fitimprurëse të transportimit dhe shitjes së njerëzve.

2. Gratë dhe vajzat që shiten në skllavëri seksuale nga familja, të dashurit ose të tjerët. Miliona janë të detyruara në shfrytëzimin seksual (prostitucion, pornografi ose argëtim).

3. Gratë, pjesa më e madhe e të cilave janë të bllokuara në varfëri dhe pa shpresë, të jenë shumë të kujdesshme ndaj “ofertave të punës” që u premtojnë atyre një jetë më të mirë, por në të vërtetë janë skllavëri seksuale. Disa adoleshente pranojnë se ishin paralajmëruar, por nuk besonin se do t’u ndodhte atyre.

4. Dëgjuesit e programit “Shpresë për ty”, i gatshëm në 73 gjuhë të ndryshme, të përjetojnë dashurinë e Zotit dhe të kuptojnë se pa marrë parasysh rrethanat e tyre, Jezusi mund t’u japë kurajo, gëzim dhe paqe.

5. Mbrotje për njerëzit që përpiqen të shpëtojnë vajzat nga prostitucioni. Kriminelët nuk janë të lumtur kur biznesi i tyre fitimprurës pengohet.

6. Ata që përfshihen në përkthimin dhe prodhimin e radiodramës ‘Thesare të fshehura’ në disa gjuhë: aktorët, teknikët, muzikantët, teknikët e efekteve zanore dhe të tjerë.

7. Mbrojtje për gratë që dëgjojnë programet “Shpresë për ty” dhe radiodramën “Thesare të fshehura” në pajisjet e vogla mediatike që mund të fshihen nga tutorët dhe abuzuesit .

8. Ata që punojnë në Shtetet e Bashkuara për të identifikuar dhe rimëkëmbur mijëra të mitur që janë shfrytëzuar seksualisht. Lutuni për dënimin e më shumë se 2,300 të dyshuarve në internet për shkelje të seksit të fëmijëve të arrestuar gjatë një operacioni tre mujor. Lutuni gjithashtu për 383 fëmijët që kanë vuajtur abuzimin seksual ose janë përdorur në prodhimin e pornografisë së fëmijëve.

9. Dënimin e gënjeshtarëve, prodhuesve të pornografisë, distributorëve të pornografisë në internet dhe të tjerëve që shkatërrojnë jetën e grave dhe fëmijëve për përfitime financiare.

10. Të rriturit që të bëjnë më shumë për të mbrojtur fëmijët e vegjël nga sulmet seksuale të anëtarëve të familjes ose kujdestarët. Lutuni që ata që u sulmuan si fëmijë nuk do të refuzohen ose do të abuzohen më tej nga të rriturit të cilëve u besojnë.

11. Miliona gra dhe vajza të detyruara në skllavëri seksuale t’u shërbejnë meshkujve në shtëpi, motele, shërbime eskortash, sallat e masazheve, klubet e zhveshjes ose hotelet, apo që prostituohen në rrugë ose detyrohen të marrin pjesë në pornografi.

12. Vajzat e reja dhe gratë viktime të trafikimit që dhunohen dhe traumatizohen emocionalisht. Shumë prej tyre janë në dëshpërim dhe e konsiderojnë vetëvrasjen si një ikje shpëtim nga mundimi i të mbyllurit brenda, të rrahurit, mosngrënies dhe përdhunimit kur u rezistojnë tutorëve të tyre, dhunuesve apo punëdhënësve.

13. Fushata ndërgjegjësimi dhe vullnetarë në vende të ndryshme që shpërndajnë fletëpalosje dhe postera për të informuar gratë për rreziqet e braktisjes së komuniteteve të tyre për të gjetur punë. Lutuni që agjencitë qeveritare do të përdorin mediat për të zbuluar të vërtetën pas këtyre ofertave të rreme të punës dhe premtimeve mashtruese për një jetë më të mirë.

14. Turistët, studentët, personelin ushtarak dhe biznesmenët për të kuptuar se shumë nga gratë që po shfrytëzojnë janë duke u detyruar t’i shërbejnë. Lutuni që këta njerëz do të ofrohen për t’i ndihmuar gratë të shpëtojnë prej tutorëve të tyre (Ezekieli 33:11).

15. Vajzat nga Vietnami, Koreja e Veriut, Laosi, Kamboxhia dhe Myanmar të cilat janë mashtruar nga të afërmit, miqtë apo të dashurit dhe u janë shitur meshkujve si nuse në Kinë, Malajzi dhe Korenë e Jugut.

16. Autoritetet që të bëjnë më shumë për të gjetur fëmijët e zhdukur dhe për të ndëshkuar ata që janë përfshirë në rrëmbimin, drogimin dhe abuzimin e këtyre të rinjve. “Mbroni të dobëtin dhe jetimin, sigurojini drejtësi të vuajturit dhe të varfërit. Çlironi të mjerin dhe nevojtarin; shpëtojeni nga dora e të pabesit.” (Psalmi 82: 3-4).

17. Gratë që kanë përjetuar përdhunim, prostituim ose abuzim. Kërkojini Zotit t’i mundësojë atyre të njohin punën e tij transformuese dhe shëruese, në

mënyrë që besimi dhe dinjiteti të mund të rikthehen.

18. Etërit të kujdesen dhe të mbrojnë vajzat e tyre, t’u japin atyre arsim dhe t’i inkurajojnë ato që të vendosin qëllime dhe të jetojnë për të lavdëruar Perëndinë në të gjitha gjërat.

19. Gratë që vuajnë nga sëmundje seksualisht të transmetueshme (përfshirë ato të lidhura me AIDS-in), kequshqyerja, tuberkulozi dhe ndërlikimet nga përdhunimet e përsëritura dhe abortet si pasojë e prostitucionit të detyruar.

20. Refugjatët që lanë shtëpitë e tyre pa marrë gjë me vete dhe tani po i shesin vajzat e tyre për të paguar qiranë ose për të blerë ushqime.

21. Emigrantët e varfër në Evropë për të gjetur punë dinjitoze në mënyrë që ata të mos detyrohen të prostitutojnë për të siguruar për familjet e tyre në vendet e tyre.

22. Oficerët e zbatimit të ligjit që të arsimohen rreth ligjeve lokale që rregullojnë dhunën ndaj grave dhe vajzave. Lutuni gjithashtu që zyrtarët që mbulojnë dhe përpiqen të mbrojnë abuzuesit kriminelë do të dënohen.

23. Lutuni që sa më shumë njerëz të bëhen të vetëdijshëm për shenjat e trafikimit të qenieve njerëzore dhe të jenë mjaft të guximshëm për t’i ndihmuar gratë të largohen nga abuzimi. Të dhënat përfshijnë dikë, komunikimi i të cilit është i kufizuar, shihet rrallë jashtë vendbanimit të saj, i mungon dokumentacioni i udhëtimit ose jeton në një ndërtesë që vizitohet shpesh nga burrat.

24. Fëmijë, gra dhe vajza adoleshente në Nepal, të cilat përdhunohen nga të afërmit ose shiten në skllavëri në Indi, Kinë dhe vende të tjera.

25. Gratë që vuajnë nga abuzimi, tradhëtia ose braktisja nga burrat e tyre. Shumë nga këto gra të paarsimuara dhe të pakualifikuara detyrohen të prostitutojnë në mënyrë që të mund të ushqejnë fëmijët e tyre.